



DENIMI ALTERNATIV PËR PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME

Autor i raportit:
Predrag Miljković

Botues:
OJQ AKTIV

Redaktor:
Miodrag Milićević

Qershor 2023.

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare nga UNMIK-u në kuadër të projektit "Mbështetje e mëtutjeshme për qasje në drejtësi dhe të drejtat e njeriut në rajonin e Mitrovicës".

Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e OJQ Aktiv dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e UNMIK-ut.

PËRMBAJTJA

▶ Hyrje	5
▶ Karakteri normativ i dënimit alternativ me punë në dobi të përgjithshme nga këndvështrimi i Kodit Penal dhe Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale	7
▶ Kodi Penal i Kosovës	7
▶ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale	8
▶ Aplikimi i dënimit alternativ me punë në dobi të përgjithshme	11
▶ Shërbimi Sprovues i Kosovës	12
▶ Studimi i realizuar dhe problemet e identifikuara lidhur me zgjedhjen e sanksioneve penale, si dhe ekzekutimi me sukses i dënimit me punë në dobi të përgjithshme	13
▶ Bashkëpunimi ndërmjet gjykatave themelore dhe shërbimit sprovues	13
▶ Problemet e shërbimit sprovues lidhur me organizimin, resurset, personelin dhe transparencën në punë	14
▶ Përvojat e vendeve të rajonit – shembulli i Malit të Zi	15
▶ Konkluzione dhe rekomandime	17

Puna në dobi të përgjithshme është një nga dënimet penale alternative që ofron mundësinë e përfshirjes së shoqërisë në ekzekutimin e tij, ku në këtë mënyrë kryesit e veprave penale ndaj të cilëve zbatohet ky dënim alternativ pa heqje lirie trajtohen si pjesëtarë të barabartë të komunitetit shoqëror, prandaj është më human se sa dënimet penale klasike.

Ky lloj dënimi alternativ mund të ndikojë që i dënuari të mos e përsërisë krimin (parandalimi i posaçëm), të ndikojë në qëndrimin e tij ndaj shkeljes së ligjit, të përmirësojë qëndrimin e tij ndaj komunitetit dhe të rrisë përgjegjësinë për respektimin e ligjit, gjegjësisht të përmbush qëllimin e paraparë të dënimit, mirëpo me një parandalim të veçantë dukshëm më të theksuar në raport me parandalimin e përgjithshëm.

Marrë parasysh sa më sipër, mund të thuhet se ky dënim përmban shpagim minimal me një risocializim të theksuar. Futja e punës në dobi të përgjithshme si dënim penal paraqitet si reagim ndaj pasojave negative të dënimeve tjera penale, në radhë të parë dënimit me burgim, i cili ka rezultuar të jetë joefektiv për kryerës të caktuar të veprave penale. Dënimet alternative pa heqje lirie paraqesin sanksione me të cilat mund të arrihet qëllimi i dënimit në kushte që janë më pak kufizuese se dënimet me burgim dhe që vonojnë shqiptimin ose ekzekutimin e dënimeve me burgim. Në legjislacionin penal të Kosovës, ky dënim mund të shqiptohet vetëm me pëlqimin e të pandehurit, lidhur me kryerjen e punës në dobi të përgjithshme. Shërbimi sprovues e zbaton këtë sanksion kështu që Ministria kompetente e Drejtësisë lidh kontratë me persona (institucione) juridik të caktuar ku kryhen punë në dobi të përgjithshme, dhe në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, përcakton të drejtat dhe detyrimet e të pandehurit gjatë ekzekutimit të dënimit.

KARAKTERI NORMATIV I DËNIMIT ALTERNATIV ME PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME NGA KËNDVËSHTRIMI I KODIT PENAL DHE LIGJIT PËR EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE PENALE

KODI PENAL I KOSOVËS

Kodi Penal i Kosovës (Ligji nr. 06/L-074) në nenin 57 parasheh që “gjykata mund t’ia shqiptojë personit të dënuar dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme nëse kryesit i shqipton dënim me gjobë deri në dymijepesëqind (2.500) Euro ose me burgim deri në një (1) vit. Puna në dobi të përgjithshme mund të caktohet vetëm me pëlqimin e personit të dënuar”. Në paragrafin 2 të të njëjtit nen thuhet “nëse e shqipton dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, gjykata e urdhëron personin e dënuar të kryejë pa pagesë, punë në dobi të përgjithshme për një periudhë të caktuar prej tridhjetë (30) deri në dyqind e dyzet (240) orë pune. Shërbimi sprovues vendos për llojin e punës në dobi të përgjithshme që duhet të kryhet nga personi i dënuar, cakton organizatën e veçantë për të cilën personi i dënuar do të kryejë punën në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës gjatë të cilave puna në dobi të përgjithshme duhet të kryhet dhe mbikëqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme”. Paragrafi 3 thekson se “puna në dobi të përgjithshme kryhet brenda një periudhe kohore të përcaktuar nga gjykata, e cila nuk e tejkalon një (1) vit”. Paragrafi 4 përcakton “nëse e shqipton dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, gjykata, po ashtu, e urdhëron personin e dënuar të mbajë kontaktin me shërbimin sprovues ose mund të urdhëroj kryerjen e një apo më shumë prej detyrimeve të parapara me paragrafin 3. të nenit 48 ose me nenin 56 të këtij Kodi.”¹ Kohëzgjatja e detyrimit të paraparë me nenin 56 nuk duhet të jetë më e shkurtër se gjashtë (6) muaj ose më e gjatë se sa tri (3) vjet.

Neni 57 paragrafi 3. i këtij Kodi zbatohet përshtatshëmrisht për detyrimin e urdhëruar me këtë paragraf.” Paragrafi 5 thotë “nëse personi i dënuar nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme, ose e kryen pjesërisht gjykata mund ta shtyjë kohëzgjatjen e mbikëqyrjes brenda kohës së verifikimit ose ta revokojë dënimin”. Ndërsa në paragrafin 6 thuhet “nëse pas kalimit të kohës së caktuar personi i dënuar nuk e ka kryer punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer vetëm pjesërisht punën e tillë në dobi të përgjithshme, gjykata urdhëron dënimin me burgim. Një (1) ditë burgim do të urdhërohet për çdo tetë (8) orë pune në dobi të përgjithshme që nuk është kryer.”

¹ Shih: nenin 48 paragrafi 3 dhe neni 56 i Kodit Penal të Kosovës (Ligji nr. 06/L-074)

Pra, siç shihet nga sa më sipër, puna në dobi të përgjithshme shfaqet si zëvendësim i dënimeve me burgim ose dënimeve me gjoba dhe

rezervohet për vepra penale më të lehta. Veçantia e këtij sanksioni pasqyrohet në vullnetarizmin e personit të dënuar, gjegjësisht domosdoshmërinë e pëlqimit të tij. Në këtë mënyrë ligjvënësi ka dashur të shmangë “punën e detyruar” në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar. Në çdo rast, siç e parashikon edhe ligji, nëse dënimi i punës në dobi të përgjithshme nuk kryhet ose kryhet pjesërisht dhe fajësia e mosekzekutimi rrjedh nga veprimet e personit të dënuar, atëherë për çdo tetë orë pune do të caktohet zëvendësimi prej një ditë burgimi.

Vlen të theksohet se në përputhje me nenin 57 paragrafi 4 dhe në lidhje me nenin 55 paragrafi 3 të Kodit Penal, gjykata me rastin e shqiptimit të këtij sanksioni në veçanti merr parasysh moshën e personit të dënuar; gjendjen e tij të përgjithshme shëndetësore dhe mendore, mënyrën e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht nevojat në lidhje me familjen, shkollën dhe punën, motivet për kryerjen e veprës penale, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, sjelljen e tij të kaluar, rrethanat e tij personale dhe ato në lidhje me familjen, dhe rrethanat tjera që janë të rëndësishme për zgjedhjen e llojit dhe kohëzgjatjes së punës.

LIGJI PËR EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE PENALE

Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (Ligji Nr. 08/L-132) në kapitullin V specifikon më hollësisht se kush, si dhe kur duhet të zbatohet dënimi alternativ me punë në dobi të përgjithshme. Në bazë të nenit 146 të këtij Ligji, kur gjykata shqipton dënimin me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës, ajo ia dërgon menjëherë aktgjykimin me të gjitha të dhënat që i posedon shërbimit sprovues kompetent për ekzekutimin e këtij dënim alternativ, dhe nëse personi i dënuar mbahet në paraburgim, gjykata po ashtu ia dërgon vendimin institucionit të paraburgimit ku mbahet ai. Drejtori i institucionit korrektues përkatës e liron personin e dënuar në mënyrë që të ekzekutohet ky dënim alternativ.

Neni 152 i LESP-së parashikon një program të punës në dobi të përgjithshme, dhe thotë se “shërbimi sprovues e zhvillon programin për punë në dobi të përgjithshme për personin e dënuar në pajtim me dispozitat e Kodit Penal të Kosovës dhe bazuar në aftësitë, shkathtësitë dhe të kaluarën e tij”.

Shërbimi sprovues e mbikëqyr ekzekutimin e dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, ndërsa në bashkërendim me organizatën ku duhet kryer puna në dobi të përgjithshme, vendosë rregullat e sigurimit për rastet e lëndimeve në vendin e punës, ose sëmundjes, sjelljen e përgjithshme në vendin e punës dhe çështjet tjera përkatëse para fillimit të punës në dobi të përgjithshme. Akti nënligjor për orarin e punës, pushimet, pushimet javore dhe mbrojtjen në vendin e punës zbatohen gjatë punës në dobi të përgjithshme.

Mbikëqyrja e kryerjes së punës në dobi të përgjithshme parashikohet nga neni 148 i LESP-së, i cili thotë se kur gjykata shqipton dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme dhe personin e dënuar e urdhëron që të kontaktojë me shërbimin sprovues, apo të përmbushë një, ose më shumë obligime sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës, shërbimi sprovues e mbikëqyrë mbajtjen e kontaktit, apo përmbushjen e obligimit. Nëse personi i dënuar nuk mban kontakt me shërbimin sprovues, ose nuk e përmbush obligimin e urdhëruar nga gjykata, shërbimi sprovues e njofton gjykatën pas verifikimit të fakteve dhe arsyeve për mos mbajtjen e kontaktit, apo mos përmbushjen e obligimit. Organet e administratës të nivelit qendror dhe lokal, institucionet dhe personat e tjerë juridik, si dhe personat fizik janë të obliguar të bashkëpunojnë me shërbimin sprovues dhe zyrat regjionale sprovuese në ekzekutimin e dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Në paragrafin 4 të këtij neni, parashikohet se “Ministri² lidhë marrëveshje të bashkëpunimit për ekzekutimin e dënimit për punë në dobi të përgjithshme nga paragrafi 3. i këtij neni. Me marrëveshje të bashkëpunimit përcaktohen të drejtat dhe detyrimet reciproke.”

Me nenin 149 të LESP parashihet që “organizata në të cilën duhet kryer puna në dobi të përgjithshme menjëherë e njofton shërbimin sprovues nëse personi i dënuar nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme në nivel të kënaqshëm. Moskryerja në nivel të kënaqshëm e punës në dobi të përgjithshme vlerësohet nga shërbimi sprovues dhe i raportohet gjykatës. Moskryerja në nivel të kënaqshëm e punës në dobi të përgjithshme nënkupton ardhjen e vonuar në punë, mungesat e palejuara nga puna, mosrespektimin e rregullave të punës.”

Neni 150 i Ligjit parasheh mundësinë e korigjimit (rishikimit) të programit të punës në dobi të përgjithshme nga shërbimi sprovues, i cili ishte përcaktuar më parë, por në këto kushte:

1. Ekzekutimi i urdhrimit për punë në dobi të përgjithshme me dënim mund të shtyhet, apo pezullohet për shkak të:

- sëmundjes së papritur të personit të dënuar, e cila kërkon trajtim mjekësor dhe atij ia pamundëson kryerjen e punës në dobi të përgjithshme;
- tvdekjes së ndonjë anëtari të familjes, që atë e obligon të merr rolin e kujdestarit kryesor ndaj anëtarëve të tjerë të familjes dhe ia pamundëson kryerjen e punës në dobi të përgjithshme;
- rrethanave të tjera të jashtëzakonshme, të cilat kërkojnë praninë e përhershme të personit të dënuar për arsye humanitare dhe atij ia pamundësojnë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme.

² Ministri i Drejtësisë së Kosovës

Kërkesa për shtyrjen, apo pezullimin e ekzekutimit të urdhrit për punë në dobi të përgjithshme mund t'i paraqitet gjykatës nga personi i dënuar, mbrojtësi, ose përfaqësuesi i shërbimit sprovues. Parashtrimi i kërkesës pezullon obligimin për kryerjen e punës në dobi të përgjithshme derisa gjykata të vendos lidhur me kërkesën. Gjykata vendos për shtyrjen, apo pezullimin e ekzekutimit të urdhrit për punë në dobi të përgjithshme të urdhëruar me dënim brenda tri (3) ditëve nga pranimi i kërkesës. Nëse gjykata e miraton shtyrjen, apo pezullimin e ekzekutimit të urdhrit për punë në dobi të përgjithshme, ajo me aktin e përcakton periudhën e shtyrjes, apo pezullimit. Shtyrja, apo pezullimi i ekzekutimit të urdhrit për punë në dobi të përgjithshme të urdhëruar mund të zgjasë:

- ☑ deri në shërimin e sëmundjes, në rastet nga nën-paragrafi 2.1 i paragrafit 2 të këtij neni.
- ☑ deri në njëzet (20) ditë, në rastet nga nënparagrafi 2.2. dhe 2.3. të paragrafit 2 të këtij neni. Përfundimi i suksesshëm i punës në dobi të përgjithshme i raportohet gjykatës nga shërbimi sprovues. Pas pranimit të raportit të tillë, gjykata merr vendim me të cilin vërtetohet mbajtja e dënimit alternativ.


Nga pikëpamja psikologjike, ky sanksion te personi i dënuar krijon ndjenjën e përkatësisë ndaj komunitetit shoqëror dhe jo ndjenjën e të qenit i refuzuar nga shoqëria. Komuniteti që shpesh beson se delikuentët duhet të izoloohen, fillon të ndryshojë mendimin e tij për ta. Duke qenë se një person i dënuar me punë në dobi të përgjithshme kryen detyrat e përditshme, kujdeset për familjen dhe kryen punë të dobishme shoqërore ose humanitare në kohën e tij të lirë, në sytë e komunitetit shoqëror krijon imazhin e një njeriu që duhet t'i jepet mundësia të bëhet anëtar i dobishëm dhe i barabartë i komunitetit, pa asnjë formë izolimi.³

³ D. Radulović, Alternative criminal sanctions in the criminal legislations of Montenegro, *Facta Universitatis: Series, Law and Politics*, br. 1, Vol. 15, str. 18.

APLIKIMI I DËNIMIT ALTERNATIV ME PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME

Sipas të dhënave statistikore të disponueshme aktualisht në Agjencinë e Statistikave të Kosovës⁴ (të cilat për fushën e drejtësisë nuk janë përditësuar që nga viti 2019), rezultojnë se në vitin 2019 gjykatat në Kosovë kanë shqiptuar 17,315 aktgjykime dënuese. Nga numri i përgjithshëm i dënimeve të shqiptuara, gjykatat themelore kanë zgjedhur dënimin me punë në dobi të përgjithshme vetëm në 106 raste. Në përqindje, ky dënim alternativ në vitin 2019 është shqiptuar vetëm 0,61% të rasteve.

DËNIMET ME PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME KRAHAS NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË SANKSIONEVE PENALE TË SHQIPTUARA NË VITIN 2019 NË KOSOVË



Kjo e dhënë na tregon se në pothuajse 99% të rasteve gjykatat kanë zgjedhur një lloj tjetër dënimi, me shumë gjasa duke pasur parasysh se me të do të përmbushin qëllimin e dënimit. Mirëpo, gjatë studimit u pa se te gjyqtarët, si rezultat i punës jo aq të mirë dhe të koordinuar të gjykatave dhe shërbimit sprovues, është i pranishëm një lloj mosbesimi se dënimin alternativ me punë në dobi të përgjithshme do të zbatohet me sukses ose të paktën do të zbatohet nga shërbimi i sprovues.

Një numër kaq i papërfillshëm i dënimeve me punë në dobi të përgjithshme duket dekurajues, nëse merret parasysh qëllimi i krijimit të dënimeve alternative, dhe veçanërisht dënimeve me punë në dobi të përgjithshme.

⁴ <https://ask.rks-gov.net/sr/agencija-za-statistiku-kosova/socijalne/pravosude>, as accessed on 05.06.2023

SHËRBIMI SPROVUES I KOSOVËS

Shërbimi Sprovues i Kosovës vepron në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës, dhe themelimi i tij konsiderohet si një nga shërbimet e para të këtij lloji në Ballkan. Është themeluar më 2 dhjetor 2002 si pilot projekt në Prishtinë, nën kompetencat e Divizionit të Menaxhimit Penal/Departamentit të Drejtësisë. Me rregulloren e UNMIK-ut 2006/26, të datës 27 Prill 2006, kompetencat për Shërbimin Sprovues të Kosovës - SHSK nga Departamenti i Drejtësisë, kanë kaluar në Ministrinë e Drejtësisë. Përgjegjësit dhe detyrat e Shërbimit Sprovues të Kosovës janë:

- ✓ organizimi, zbatimi dhe mbikëqyrja e ekzekutimit të dënimeve alternative dhe të riintegritit shoqëror të personave të dënuar (punët sprovuese);
- ✓ përgatitja e anketës sociale dhe raporteve parandëshkuese për kryerësit e veprave penale;
- ✓ vlerësimi i rrezikut kriminogjen dhe për caktimin e nevojave për trajtim të kryesve të veprave penale;
- ✓ ekzekutimi i masave të diversitetit dhe masave edukative për të mitur;
- ✓ mbikëqyrja dhe ndihma ndaj personave të dënuar gjatë mbajtjes së dënimeve alternative;
- ✓ mbikëqyrja dhe ndihma ndaj kryerësve të varur nga droga, ose alkooli të cilët i nënshtrohen trajtimit të detyrueshëm rehabilitues i cili mbahet në liri;
- ✓ mbikëqyrja dhe ndihma ndaj personave të dënuar të liruar me kusht;
- ✓ zhvillimi i programeve individuale të mbikëqyrjes;
- ✓ hartimi i raporteve për ekzekutimin e dënimeve alternative dhe personave të liruar me kusht nga burgu për Prokuroritë, Gjykatat dhe Panelin për Lirim me Kusht;
- ✓ udhëzimi dhe mbështetja ndaj personave të dënuar në përfundim të dënimit të tyre;
- ✓ mbajtja e evidencave dhe regjistrave për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative në sistemin elektronik për menaxhimin e të dhënave;⁵

Shërbimi Sprovues i Kosovës është i organizuar dhe përbëhet nga: Zyra Qendrore e Shërbimit Sprovues me seli në Prishtinë dhe Zyrat rajonale sprovuese.

⁵ <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=3,19>

STUDIMI I REALIZUAR DHE PROBLEMET E IDENTIFIKUARA LIDHUR ME ZGJEDHJEN E SANKSIONEVE PENALE, SI DHE EKZEKUTIMI ME SUKSES I DËNIMIT ME PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME

Në fillim duhet theksuar se çdo zgjedhje e sanksionit penal përfaqëson diskrecionin e gjyqtarit gjykues në përputhje me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale. Meqenëse në të drejtat diskrecionale të gjyqtarëve nuk mund dhe nuk duhet të ndërhyhet, tema e këtij studimi ishte se çfarë mendojnë gjyqtarët në Kosovë për dënimet alternative, çfarë problemesh hasin gjatë punës së tyre dhe çfarë i shtyn më së shpeshti të vendosin që të mos e shqiptojnë këtë dënim, ngase është më se e qartë se shumë pak dënime me punë në dobi të përgjithshme janë shqiptuar. Në anën tjetër, për nevojat e studimit është realizuar një anketë me udhëheqësin e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Sprovues në Mitrovicë lidhur me problemet dhe pengesat me të cilat ballafaqohet ky shërbim në punën e tij, si dhe rekomandimet për përmirësimin e punës së gjykatave dhe shërbimeve sprovuese, por edhe shërbimit sprovues me institucione të tjera.

BASHKËPUNIMI NDËRMJET GJYKATAVE THEMELORE DHE SHËRBIMIT SPROVUES

Sipas informatave të mbledhura, në rastin konkret niveli i ulët i bashkëpunimit të Shërbimit Sprovues të Kosovës me Gjykatat Themelore në Kosovë dhe anasjelltas është një nga problemet më të mëdha, e që është një fakt shumë i pakënaqshëm, nëse marrim parasysh se shërbimi sprovues duhet të jetë “dora e zgjatur” e gjykatave. Gjegjësisht, lidhja dhe koordinimi i tyre është vendimtar për zbatimin e suksesshëm të ligjit. Të dyja palët mohojnë një nivel të mjaftueshëm bashkëpunimi, kështu që nga shërbimi sprovues mund të dëgjojmë se gjykatat shpeshherë nuk e informojnë shërbimin sprovues për sanksionin e shqiptuar, prandaj edhe nuk janë në gjendje të kryejnë mbikëqyrjen apo ekzekutimin. Përkundër kësaj, gjykatat pretendojnë se për shërbimin sprovues i dorëzojnë aktgjykimet në mënyrë të rregullt, por se shërbimi sprovues nuk dorëzon raporte mbi mbikëqyrjen dhe veprimet e ndërmarra. Për më tepër, tek gjyqtarët, si problem u vu re njëfarë paqartësie se dënimi me punë dobi të përgjithshme do të zbatohet me sukses, por edhe se qëllimi i dënimit me dënimin me punë në dobi të përgjithshme do të përmbushet me sukses. Gjithashtu, gjatë studimit është vërejtur se gjyqtarët marrin pjesë në seminare vjetore të organizuara nga KGJK-ja, por shumë pak nga ato seminare kanë të bëjnë me llojet alternative të dënimeve dhe zbatimin e tyre. Nisur nga sa më sipër, arsyeja kryesore për mos shqiptimin e këtij lloji të sanksionit apo dënimit konsiderohet bashkëpunimi i pamjaftueshëm i gjykatës me shërbimin sprovues dhe si rrjedhojë gjyqtarët më shpesh vendosim për sanksione të tjera penale.

PROBLEMET E SHËRBIMIT SPROVUES LIDHUR ME ORGANIZIMIN, RESURSET, PERSONELIN DHE TRANSPARENCËN NË PUNË

Të dhënat e fituara gjatë studimit tregojnë se shërbimi sprovues po përballet me probleme në formën e resurseve të pamjaftueshme dhe për këtë arsye përpiqet të lidh marrëveshje (kontrata) bashkëpunimi me sa më shumë institucione. Megjithatë, ajo që gjatë studimit u vërejt është pamundësia e identifikimit më të saktë të nivelit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të ndryshme dhe shërbimit sprovues (problemi i transparencës së SHSK-së), sepse edhe pse është i rëndësishëm fakti që bashkëpunojnë me një numër të madh institucionesh, më me rëndësi ndoshta do ishte të dihet se për cilat institucione bëhet fjalë dhe sa janë të përshtatshme që në to të zbatohet dënimi me punë në dobi të përgjithshme. Si shembuj, shërbimi sprovues thekson: bibliotekat, auto shkollat, zjarrfikësit etj.

Që ky problem të tejkalohet, është e nevojshme të përcaktohet se çfarë lloj pune do të ishte më e "përshtatshme" për dobi të përgjithshme (interes shoqëror), dhe rrjedhimisht të gjendet një institucion adekuat. Për shembull, kryerja e punës në dobi të përgjithshme në auto shkollë konsiderohet se nuk paraqet punë në dobi të përgjithshme. Auto shkollat më së shpeshti zhvillojnë veprimtarinë e tyre në sferën private, nga ana tjetër, mbetet e paqartë se çfarë lloj pune në auto shkollë do t'i kontribuonte shoqërisë. Gjatë ekzekutimit të dënimit me punë në dobi të përgjithshme, është e nevojshme të merren parasysh të gjitha rrethanat personale dhe profesionale të kryerësit (njohuritë e veçanta, aftësitë, gjendja shëndetësore, etj.), si dhe nevojat e komunitetit shoqëror në të cilin puna në dobi të përgjithshme kryhet. Si shembull mund të marrim një vend me reshje të shpeshta bore. Ndoshta, në këtë rast, interesi publik do të përmbushet më së miri përmes pastrimit, mirëmbajtjes dhe kalueshmërisë së rrugëve publike. Ndërsa, nëse vendi është i pasur me pyje, liqene ose lumenj (ose është vend turistik), puna në dobi të përgjithshme në atë rast do të përmbushet më së miri me një lloj mirëmbajtjeje të zonave të tilla publike. Natyrisht, me të gjitha masat paraprake të përcaktuara nga LESP dhe ndalimit të kryerjes së punëve të rënda fizike ose të atyre që përfshijnë shkallë të lartë rrezikshmërie, njohuri të veçanta etj.

Një problem tjetër që vlen të theksohet është puna jo mjaft transparente e Shërbimit Sprovues të Kosovës. Gjatë studimit është vërejtur se në nivel rajonal SHSK-ja nuk ka ueb faqe me informacione kontakti, nuk ka statistika të publikuara zyrtarisht mbi numrin e personave të cilëve iu është shqiptuar një nga dënimet që zbatohen nga Shërbimi Sprovues i Kosovës (të dhënat sigurohen me kërkesë), edhe pse këto të dhëna duhet të jenë të njohura për publikun ato përndryshe publikohen si pjesë e buletineve statistikore vjetore. Pastaj, të dhënat për suksesin në punë (risocializimi i personave të dënuar) apo numrit të të kthyerve, kontratat e shpallura publikisht me institucionet me të cilat janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi etj.

PËRVOJAT E VENDEVE TË RAJONIT – SHEMBULLI I MALIT TË ZI

Për dallim nga Kodi Penal i Kosovës, Kodi Penal i Malit të Zi⁵ parasheh dënimin me punë në dobi të përgjithshme si dënim kryesor krahas dënimit me burgim afatgjatë, dënimin me burgim dhe dënimin me gjobë⁶. Pra, me inkorporimin e dënimin me punë në dobi të përgjithshme, Mali i Zi vendosi që këtë dënim ta përcaktojë si dënim kryesor, pra dënim që mund të shqiptohet edhe si i vetëm. Të dhënat statistikore që u mblodhën gjatë studimit paraqesin një shembull të mirë të transparencës së punës së institucioneve të Malit të Zi. Tabela në vijim dokumenton qartë numrin e dënimeve të shqiptuara me punë në dobi të përgjithshme përmes një analize gjatësore nga viti 2012 deri në vitin 2021, ku është i paraqitur numri i dënimeve të shqiptuara nga gjykatat dhe bilanci total i dënimeve të shqiptuara me punë në dobi të përgjithshme.

⁶ <https://www.paragraf.me/propisi-crnegore/krivicni-zakonik-crne-gore.html>

⁷ Article 33 of the Criminal Code of Montenegro („Official Gazette of Montenegro No. 70/2003, 13/2004 – corr. and 47/2006 i „ Official Gazette of Montenegro No. 40/2008, 25/2010, 32/2011, 64/2011 – other law, 40/2013, 56/2013 – corr. 14/2015, 42/2015, 58/2015 – other law 44/2017, 49/2018 i 3/2020)

Nga të dhënat e mbledhura shihet qartë se ka një tendencë drejt rritjes së përqindjes së dënimin me punë në dobi të përgjithshme krahas numrit të përgjithshëm të dënimeve të shqiptuara, kështu që në Mal të Zi në vitin 2012 janë shqiptuar vetëm tetë nga këto dënime, në vitin 2013 - 32, në 2014 - 96, 2015 - 172, 2016 - 225, 2017 - 287, 2018 - 226, 2019 - 262, 2020 - 218, 2021 - 173, përkatësisht për periudhën e në fjalë gjithsej 1699 dënime. Dënimi me punë në dobi të përgjithshme krahas dënimin me gjobë, dënimin me kusht, dënimin me burgim dhe dënimeve tjera merr pjesë mesatarisht me 4,8%. Për shembull, në vitin 2019, dënimi me punë në dobi të përgjithshme në Mal të Zi përbënte 7.75% të dënimeve të tjera të shqiptuara, ndërsa në të njëjtin vit në gjykatat e Kosovës, kjo përqindje ishte 0.6%.

Tabela e numrit të dënimeve të shqiptuara me punë në dobi të përgjithshme në Mal të Zi për periudhën 2012-2021⁸

GJYKATA THEMELORE	VIT										GJITHSEJ
	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	
Tivar	0	0	1	10	20+1	21	7	13	21+2	17+1	110
Berane	0	0	0	9	21	41	16	30	26	10	153
Bijello Pole	0	0	17	18	29	21	7+1	17+1	12	10+2	131
Cetinë	2+1	19	24	22	29	19	5	3+1	4	2	129
Danillovgrad	4	5+1	0	1	1+1	3	8+1	11+1	3	5+1	41
Herceg Novi	0	1	9	15	10	9	2+1	8	7	15	76
Kollashin	0	0	0	1+1	0	0	1+1	2+2	4+4	2+2	10
Kotor	2+1	2+2	10+1	22	21	25	23	34	30+6	24	193
Nikshiq	0	0	11	35	38	47	37	36	9+1	6	219
Plavë	0	0	0	0	2	23	35	8	18	8	94
Plevlë	0	0	0	1+1	0	1	0	4	0	0	6
Podgoricë	0	3	20	33	48	68	73	80	52+2	67	444
Rozhajë	0	0	0	0	1	3	1	1	6	0	12
Ulqin	0	2+1	4	5+1	5	5	1	5	15	2	44
Zhablak	0	0	0	0	0	1	10	10	11	5+2	37
GJITHSEJ	8	32	96	172	225	287	226	262	218	173	1.699

⁸ V. Simonovic, Center for monitoring and research - CeMI, Penal policy and application of alternative sanctions in Montenegro (original title: Kaznena politika i primjena alternativnih sankcija u Crnoj Gori), Podgorica, 2002, page 11.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Rekomandime për gjykata

1. Është e nevojshme të krijohet një mekanizëm që do të iniciojë “fillimin” e bashkëpunimit ndërmjet gjykatave dhe shërbimit sprovues në të gjitha nivelet, shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave, si dhe organizimin e seminareve të ndryshme me synim të avancimit të ndërsjellë. Gjatë studimit rezultoi se mekanizmi ndërmjet gjykatës dhe shërbimit sprovues mund t’i besohet sektorit të OJQ-ve, dhe atë për disa arsye. Arsyeja e parë është neutraliteti i tyre në rastin konkret, ngase gjykatat dhe shërbimi sprovues i përkasin “shtyllave” të ndryshme të pushtetit (gjyqësor dhe ekzekutiv), ndërsa arsyeja e dytë dhe jo më pak e rëndësishme është gatishmëria dhe interesi i shfaqur për zgjidhjen e problemeve institucionale. Në lidhje me sa më sipër, është e nevojshme të theksohet se ky lloj bashkëpunimi aktualisht është më i nevojshëm që të vendoset në mes të Gjykatës Themelore në Mitrovicë dhe Shërbimit Rajonal Sprovues në Mitrovicë, ngase në rajonin e Mitrovicës janë vërejtur raportet më poroze ndërmjet gjykatës dhe SHSK-së;

2. Me qëllim të trajnimit adekuat të gjyqtarëve, përfshirë prokurorët e shtetit, si dhe përvetësimin e njohurive të veçanta në fushën e zbatimit dhe ekzekutimit të dënimeve alternative, duhet të hartohet një doracak i veçantë që do t’i ndihmonte gjyqtarët në punën e tyre të përditshme (bazuar në Doracaku për procedurën kontesitmore i publikuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës⁹);

Si rekomandim për Shërbimin Sprovues të Kosovës, është e nevojshme:

3. Të bëhet një organizim më i mirë i punës në nivel rajonal, gjegjësisht të identifikohen nevojat e komunitetit shoqëror në rajonin përkatës (puna nuk duhet të jetë e çdo lloji por duhet të jetë e dobishme për shoqërinë);

4. Të rritet numri i zyrtarëve mbikëqyrës të kualifikuar¹⁰;

5. Të orientohet aspekti i bashkëpunimit me institucionet tjera, dhe atë në vend të aspiratës ekzistuese të bashkëpunimit me “një numër të madh institucionesh” drejtë bashkëpunimit me “institucione adekuate”;

6. Të krijohet një mekanizëm nga një organ i pavarur që do të mbikëqyrë të gjithë procesin e ekzekutimit të dënimeve që zbatohen nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, e në veçanti dënimin me punë në dobi të përgjithshme, si dhe monitorimin e punës së institucioneve ku ky dënim zbatohet, lidhur me cilën punë do të publikoheshin raportet tremujore dhe vjetore, të cilat përveç gjendjes së konstatuar (suksesi në risocializim, recidivizmit të personave të dënuar, vërejtjet dhe rekomandimet për avancim etj.) do të përmbanin edhe të gjitha të dhënat e nevojshme statistikore.

⁹ https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/doracakKontestimSQ_.pdf

¹⁰ It refers to officials who would be subjected to special programs, seminars and training in appropriate fields (pedagogy, psychology, sociology, criminology, penology, etc.) for the sake of their professional development.

7. Transparencë më e madhe në punën e SHSK-së, në formën e krijimit të ueb faqeve të veçanta me të gjitha informacionet për shërbimin sprovues rajonal, raporte mujore, tremujore ose vjetore, shembuj të “historive të suksesit”, të dhëna statistikore, bibliografi të caktuara apo publikime të akteve ligjore dhe nënligjore që zbatohen në punë;
8. Nivel dukshëm më i lartë i bashkëpunimit me gjykatat, veçanërisht forcimi i bashkëpunimit në rajonin e Mitrovicës;
9. Gjithashtu, është e nevojshme të punohet në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për ekzistimin dhe zbatimin e llojeve alternative të dënimeve, veçanërisht për faktin se shqiptimi i dënimit për punë në dobi të përgjithshme kushtëzohet me pëlqimin e të akuzuarit.

Në fund, duhet theksuar se krahas avancimit të vazhdueshëm të zgjidhjeve legjislativë, po aq i rëndësishëm është edhe zbatimi i zgjidhjeve të tilla në praktikë, të cilat në fund të fundit pa zbatimin adekuat të tyre mbeten “fjalë boshe në letër”. Edhe pse sistemi gjyqësor i Kosovës është në njëfarë mënyre i pari në Ballkan që ka përfshirë dënimin alternativ me punë në dobi të përgjithshme në legjislativë e tij penal, sigurisht që është i fundit për sa i përket zbatimit të tij.

